

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTERIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE Министарство Рада И Социјалне Заштите Agjencioni Inspektoratit të Punës	
Izhirëna Agjencija Inspektoratit të Punës No. Str. Org. Org. Jedinica No. Str. Org.	No. Prot. 106/2014 Data 08.12/2014 Prishtinë Prishtinë-Prishtinë
No. Fajdeve No. Stranica No. pages 02	



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA**  
**QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA**

**MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE**  
**MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE**  
**MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE**

**Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës**

Bazuar në dispozitën e nenit 94 të Ligjit Nr.03/L-212 I Punës të Kosovës, nenit 24 të Ligjit Nr. 04/L-161 Për Siguri dhe Shëndet në Punë, nenit 4 dhe 6 të Ligjit Nr.2002/9 për Inspektoratin e Punës në Kosovë, dhe Ligjit nr. 03/L-017. Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës nr. 2002/9, Vendimit Nr. 94/2014 dhe nenit 136 të Ligjit nr. 02/L-28 për Procedurë Administrative. Organi i shkallës së dytë i TEIP-së, Basri Ibrahim, Murat Vokshi, Agim Millaku dhe Jovica Filipović duke vendosur sipas Ankesës së subjektit në procedurë "RTK-vës" me seli në Prishtinë të ushtruarë kundër Ven-imit të Organit të shkallës së parë të TEIP-së 01 Nr. 06-1331-1/2014 marrin:

**V E N D I M**

**APROVOHET** Ankesa e subjektit në procedurë "RTK-vës" me seli në Prishtinë. Rr. "XHEMJL IBISHI" Nr.12

**SHFUQIZOHET** Vendimi dhe ju kthehet në rishqyrtim i inspektorëve të punës me 01 Nr. 06-131-1 /2014.

**A R S Y E T I M**

Me vendimin e inspektorëve të punës me me 01 Nr. 06-131-1 /2014 i datës 29. 10. 2014, është aprovuarë Kërkesa e Arsim Halili me Nr. 06-131-1/2014 e dates 10.10.2014 si e bazuar, sepse janë konstatuarë shkelje të dispozitave të nenit 14 paragrafi 2 dhe nenit 18 paragrafi 2 nenit 19 paragrafi 1 dhe nenit 21 të Rregullores për Përgjegjësi Materiale dhe Disiplinore, të subjektit në procedurë "RTK-vës" me seli në Prishtinë. Rr. "XHEMJL IBISHI" Nr.12 i është dhënë afat prej 8 ti eliminoj parregullsitë e konstatuara nga inspektorët e punës për shqiptimin e masës disiplinore Vërejtje me shkrim ndaj punonjësit Arsim Halili dhënë nga subjekti në procedurë. Kundër këtij vendimi në afatin ligjor ka ushtrua ankesë subjekti në procedurë "RTK-vës" me seli në Prishtinë. Rr. "XHEMJL IBISHI" Nr.12. Vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe Zbatim të gabuar të dispozitave materiale. Me propozim që T E I P-nës të aprovoi ankesën dhe vendimin e kundërshtuar ta anuloi. T E I P i shqyrtoi shkresat e lëndës dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore gjeti se.

### **Ankesa është e bazuar**

TEIP duke u kujdesur si pas detyrës zyrtare conform nenit 94 të Ligjit Nr.03/L-212 I Punës të Kosovës, neneve 4 , 6 të Ligjit nr 03/L-017. Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës nr. 2002/9. Gjeti se vendimi i kundërshtuar përbën aplikim të gabuar të dispozitave ligjore. Duke i vlerësuar pretendimet ankimore të subjektit në procedurë se vendimi i kundërshtuar përmban aplikim të gabuar të dispozitave ligjore të Ligjit Nr.03/L-212 I Punës të Kosovës. TEIP gjeti se ky pretendim ankimor është i bazuar, përkundrazi diapozitivi i vendimit të kundërshtuar është i pa qartë dhe i pa kuptueshëm dhe përmban arsye për aplikim jo të drejtë të dispozitave ligjore dhe mbi faktet vendimtare që vendimin e bëjnë të pa qartë dhe të pa kuptueshëm. Pretendimi ankimor se në vendimin e kundërshtuar, gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, pas vlerësimit të TEIP është i bazuar. Inspektorët e punës me Raporte Zyrtarë 01 Nr. 06-131/2014, kanë konstatuar në mënyrë jo të plotë gjendjen faktike, nga Marrëdhënia e punës, ku kanë konstatuar se subjekti në procedurë nuk ka respektuar dispozitat ligjore të nenit 85 pika 1.2 të Ligjit Nr.03/L-212 I Punës të Kosovës dhe nenit 14 paragrafi 2 dhe nenit 18 paragrafi 2 nenit 19 paragrafi 1 dhe nenit 21 të Rregullores për Përgjegjësi Materiale dhe Disiplinore të subjektit në procedurë "RTK-vës" me seli në Prishtinë. Dhe në bazë të këtij raporti kanë nxjerrë vendim 01 Nr. 06-129-1 /2014 i datës 03. 10. 2014. ku është aprovuarë Kërkesa si e bazuar e Arsi Halili me 01 Nr. 06-131/2014, por në bazë të fakteve që janë sjellë me ankesë si dhe arsyeshmëria e Ankesës së pales në procedure, TEIP-së ka konstatuarë se subjekti në procedure ka respektuarë dispozitën e ligjit të punës të nenit 85, dispozita të cilat parashohin, shqiptimin e masave disiplinore ndaj punonjësve në rastë të mosrespektimit të detyrave të punës e në këtë rast shqiptimi i masës disiplinore vërejtje me shkrim ndaj të punësuarit Arsim Halili është në harmoni me këtë dispozitë ligjore si dhe ka zhvilluar procedurën disiplinore duke respektuar dispozitat ligjore të ligjit të punës dhe të rregulloreve të brendshme të vetë subjektit në procedurë ku komisioni disiplinor ka konstatuar gjendjen faktike se Arsim Halili ka bërë shkelje të detyrës së punës, dhe me vendim Nr. 2179/2014 i është shqiptuar masa disiplinore vërejtje me shkrim, nga kjo shihet se është respektuar dispozita ligjore e nenit 85 nen i cili parasheh këtë masë disiplinore, nga kjo rezulton se subjekti në procedurë ka respektuar dispozitat ligjore të Ligjit Nr.03/L-212 I Punës të Kosovës dhe dispozitat ligjore të nenit 14 paragrafi 2 dhe nenit 18 paragrafi 2 nenit 19 paragrafi 1 dhe nenit 21 të Rregullores për Përgjegjësi Materiale dhe Disiplinore të subjektit në procedurë. Andaj faktet e bashkangjitura me ankesë, kanë rezultuar që vendimi është dashtë të anulohet dhe çështja tu kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje, me qëllim që inspektorët e punës pas administrimit të serishëm të provave dhe vlerësimit të tyre ti eliminonin shkeljet esenciale, materiale në atë mënyrë që edhe njëherë të nxjerrin vendim meritot. Prezantimi i këtyre fakteve me ankesë dhe gatishmëria e subjektit për bashkëpunim me institucionet e Republikës së Kosovës janë rrethana të cilat duhet shqyrtuar dhe analizuar nga inspektorët e punës sepse nga kjo shihet qartë se ashtë një subjekt seriozë, që në vazhdimësi është duke punuar për krijimin e kushte për punëtorët me një standardë në përputhje me Ligjin e Punës. Nga si u tha më lartë u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

Prishtinë: 08.12. 2014.

Kryeinspektori i Punës

Basri Ibrahim

